

Pika 12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 15781 Prot.

Patos, më 26/05/2025

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 25, datë 26/05/2025

**PËR MIRATIMIN E MARRVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NË KUADËR TË
GRANTIT TË PËRFORMANCËS PËR “PLANIN E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR” DHE “PLANI I BARAZIZ GJINORE” TË LIDHUR
MIDIS SHOQATËS KOMBËTARE TË BASHKIVË TË SHQIPËRISË DHE
BASHKISË PATOS**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Mbështetur të pikës “n” nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore për arsimin parauniversitar”, si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, datë 10.07.2024 “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”, ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

1. Miratimin e marrveshjes së bashkëpunimit në kuadër të grantit të performancës për “Planin e Arsimit Parauniversitar” dhe “Plani i Barazizë Gjinore” të lidhur midis Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe Bashkisë Patos.
2. Efektet financiare që do të lindin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi do të mbulohen brenda fondit të planifikuar për shpenzime operative në Programin e Arsimit të Mesëm dhe në Programin e Përkujdesit Social.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT TË ARSIMIT TË MESËM
EKIPI I PROGRAMIT TË PËRKUJDESIT SOCIAL

Drejtues i Programeve

Elda Goxhaj



Anëtar të programit të Arsimit të Mesëm:

Anëtar të programit të Përkujdesit Social:

1.Dorian Shpata

2.Fationa Xoxi

3.Fatjon Mici

4.Lindita Qalliaj




1.Barie Goxhaj

2.Fabiola Dervishaj

3.Besjana Hoxhaj

4. Fatjon Mici



Juriste

Nurkë Hazizaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 1578 Prot

Patos, më 26/05 / 2025

RELACION

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NË KUADËR TË
GRANTIT TË PERFORMANCËS PËR “PLANIN E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR” DHE “PLANIN E BARAZISË GJINORE” TË LIDHUR
MIDIS SHOQATËS KOMBËTARE TË BASHKIVË TË SHQIPËRISË DHE
BASHKISË PATOS**

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për hartimin e planeve lokale dhe në kuadër të grantit të performancës dedikuar bashkive, Bashkia Patos shpreh angazhimin për hartimin e këtyre dokumenteve strategjike, ekspertiza e të cilëve ofrohet nga Shoqata Kombëtare e Bashkive e cila do të mbulojë 70 % koston financiare të planit, ndërsa 30 % do të mbulohet nga Bashkia Patos.

Kjo marrëveshje përfshin hartimin e këtyre dokumenteve strategjike:

- Planin e Arsimit Parauniversitar
- Planin e Barazisë Gjinore

Shërbimi i ekspertizës së ofruar nga Shoqata do të përfshijë:

- Analizën, draftimin dhe konsultimin e objektivave strategjikë.
 - Mbështetjen për planifikimin e burimeve financiare.
 - Detajimin e aktiviteteve dhe projekteve.
 - Detajimin e masave për përmirësimin e arsimit dhe shërbimit social në Bashkinë Patos.
1. Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit në kuadër të grantit të performancës për “Planin e Arsimit Parauniversitar” dhe “Planin e Barazisë Gjinore” të lidhur midis Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe Bashkisë Patos.
 2. Efektet financiare që do të lindin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi do të mbulohen brenda fondit të planifikuar për shpenzime operative në Programin e Arsimit të Mesëm dhe në Programin e Përkujdesit Social.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit dhe Drejtoria e Financës.

Drejtues i Programeve
Elda Goxhaj




Anëtar të Programit të Arsimit të Mesëm:

- 1.Dorian Shpata
- 2.Fationa Xoxi
- 3.Fatjon Mici
- 4.Lindita Qalliaj



Anëtar të Programit të Përkujdesit Social:

- 1.Barie Goxhaj
- 2.Fabiola Dervishaj
- 3.Besjana Hoxhaj
4. Fatjon Mici





SHQATA
KOMBETARE
E BASHKIVE
TE SHQIPERISE

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në kuadër të grantit të performancës për:

“Planin e Arsimit Parauniversitar”

“Planin e Barazisë Gjinore”

Ndërmjet

Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë

Dhe

Bashkisë Patos

Maj, 2025



SHOQATA
KOMBETARE
E BASHKIVE
TE SHQIPERISE

PËRMBAJTJA:

1. Rreth Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë.

2. Objekti

2.1. Përshkrimi i angazhimit të Shoqatës

2.3 Kontributi i Bashkisë

2.3 Periudha e zbatimit

2.3.1 Kostot e Projektit për Bashkitë e vogla (me më pak se 50,000 banorë)



Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë është organizata përfaqësuese e njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri. Ajo funksionon si një forum bashkëpunimi, mbrojtjeje të interesave dhe ndarjeje të praktikave më të mira mes bashkive të vendit.

Misioni

Misioni i SHKBSH është të forcojë qeverisjen vendore përmes:

- Zërit të përbashkët të bashkive në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar,
- Rritjes së kapaciteteve institucionale të njësive vendore,
- Promovimit të decentralizimit dhe demokracisë vendore.

1. Objektivat kryesore

- Përfaqësimi i interesave të bashkive pranë institucioneve qendrore dhe ndërkombëtare.
- Nxjtja e bashkëpunimit ndërmjet bashkive përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira.
- Mbështetja teknike dhe trajnime për administratën vendore.
- Fuqizimi i autonomisë vendore dhe zbatimi i parimit të subsidiaritetit.

2. Aktivitetet

- Organizimi i forumeve, konferencave dhe trajnimeve për çështje të zhvillimit lokal;
- Hartimi i politikave dhe rekomandimeve për përmirësimin e legjislacionit për vetëqeverisjen vendore;
- Zbatimi i projekteve në fusha si: zhvillimi ekonomik lokal, mbrojtja e mjedisit, përfshirja sociale, barazia gjinore, dhe digjitalizimi i shërbimeve.

3. Objekti

Objekti i kësaj shprehjeje interesi është bashkëpunimi ndërmjet *Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe Bashkisë Patos*. Në kuadër të grantit të performancës dedikuar bashkive në përmbushje të detyrimit ligjor të hartimit të planeve lokale të shërbimit, shprehin interesin për të bashkëpunuar me qëllim hulumtimin dhe shpërndarjen e ekspertizës në fushën e arsimit parauniversitar në nivelin vendor.

Objekti i kësaj marrëveshjeje është që *Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë* të mbështesë Bashkinë Patos në hartimin e **Planit të Arsimit Parauniversitar, Planit të Barazisë Gjinore** në nivel vendor, ku bashkia shprehin angazhimin për t'u bashkuar në këtë iniciativë, duke bashkë-kontribuar me 30% të vlerës së këtyre planeve.

Shërbimi i ekspertizës i ofruar nga Shoqata përfshin:

- Analizën, draftimin dhe konsultimin e objektivave strategjike,
- Mbështetjen për planifikimin e burimeve financiare,
- Detajimin e aktiviteteve dhe projekteve,
- Detajimin e masave për përmirësimin e arsimit dhe shërbimit social në këto bashki.



Ky bashkëpunim synon të kontribuojë në rritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar dhe shërbimit social si dhe përmirësimin e planifikimit strategjik në nivel vendor.

2.1. Përshkrimi i angazhimit të Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë

Shoqata merr përsipër të ofrojnë ekspertizën e mëposhtme:

1. **Analizë demografike dhe sociale e Bashkisë:** Ofrimi i një analize të detajuar të të dhënave demografike dhe sociale të Bashkisë, duke përfshirë informacion mbi popullsinë dhe strukturat sociale.
2. **Përcaktimi dhe rishikimi i kuadrit ligjor dhe politikave:** Rishikimi dhe përcaktimi i kuadrit ligjor dhe politikave, bazë dhe referencë për t'u zbatuar në nivelin vendor në ofrimin e shërbimit të arsimit parauniversitar dhe social nga bashkia.
3. **Analizë e të dhënave dhe shërbimeve arsimore në nivelin parashkollor, arsimit të mesëm dhe arsimit profesional, si dhe shërbimit social:** Ofrimi i një analize të detajuar të të dhënave dhe shërbimeve arsimore dhe social, duke identifikuar sfidat dhe nevojat për përmirësim ose për arritjen e standardeve ligjore.
4. **Zhvillimi i qëllimit të Planit të Arsimit Parauniversitar, Barazise Gjinore dhe Social për Bashkinë:** Përcaktimi i qëllimeve dhe identifikimi i prioritetëve.
5. **Zhvillimi i objektivave të përgjithshme për arsimin:** Përcaktimi i objektivave të përgjithshme, duke përfshirë qëllime të qarta dhe të matshme.
6. **Përcaktimi i masave strategjike dhe aktivitetëve të planit:** Identifikimi i masave strategjike dhe aktivitetëve të nevojshme për realizimin e këtyre objektivave.
7. **Analizimi i burimeve financiare lokale dhe mundësitë për financim nga donatorë të tjerë:** Ofrimi i një analize të burimeve financiare lokale dhe mundësive për financim nga donatorë të tjerë, për të siguruar mbështetje financiare për zbatimin e planit.
8. **Hartimi i Planit të detajuar të investimeve kapitale:** Hartimi i një plani të detajuar të investimeve kapitale për përmirësimin e infrastrukturës arsimore.
9. **Hartimi i një mekanizmi monitorimi dhe vlerësimi:** Zhvillimi i një mekanizmi për monitorimin dhe vlerësimin e masave dhe projekteve të përfshira në plan, për të siguruar efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit.
10. **Zhvillimi i një plani raportimi:** Hartimi i një plani të qartë raportimi për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien në lidhje me realizimin e masave dhe aktivitetëve të planit, përfshirë mundësinë për vlerësim të vazhdueshëm dhe përmirësim.
11. **Të sigurojë harmonizimin e qasjes metodologjike në mënyrë që plani i arsimit parauniversitar të jetë në përputhje me prioritetet kombëtare dhe praktikatat më të mira.**



2.2 Kontributi i Bashkisë

1. **Sigurimi i të dhënave lokale:** Bashkia duhet të sigurojë të dhëna demografike dhe sociale të përditësuara, si dhe informacion për proceset dhe produktet e shërbimit që ofron Bashkia në fushën e arsimit parauniversitar dhe social. Këto të dhëna do të jenë të rëndësishme për analizat e mëtejshme.
2. **Sigurimi i informacionit lidhur me institucionet arsimore dhe shërbimin social:** Bashkia do të ofrojë informacion lidhur me statusin dhe aspekte të detajuara.
3. **Pjesëmarrja aktive në validimin e gjetjeve dhe nevojave për përmirësim:** Bashkia do të marrë pjesë aktive në validimin e gjetjeve dhe identifikimin e nevojave për përmirësim, përcaktimin e objektivave dhe masave strategjike, si dhe në identifikimin e aktiviteteve dhe projekteve që do të përfshihen në planin, duke i prioritarizuar ato.
4. **Organizimin e konsultimeve dhe takimeve publike:** Bashkia do të luajë një rol kyç në organizimin dhe mbështetjen e konsultimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e aktorëve lokalë dhe transparencë në proces.
5. **Buxheti dhe financimi:** Bashkia duhet të sigurojë informacionin e domosdoshëm për financimin e arsimit parauniversitar dhe shërbimit social në tre vitet e fundit, përfshirë të dhëna për kostot dhe projektet e realizuara. Gjithashtu, Bashkia do të kontribuojë në identifikimin e kostove dhe burimeve financiare të disponueshme për alokim, për planifikimin e masave strategjike dhe aktiviteteve të planit për një periudhë trevjeçare.
6. **Mbështetje në monitorim dhe vlerësim:** Bashkia do të bashkëpunojë për të vendosur treguesit e duhur për monitorimin dhe vlerësimin efektiv të zbatimit të planeve, duke siguruar që të gjitha masat dhe aktivitete të jenë të monitoruara dhe të vlerësuara në mënyrë të qartë dhe të strukturuar.

2.3 Periudha e zbatimit

SHKBSh do të bashkëpunojë me **Bashkinë Patos** për hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar dhe Planit të Barazisë Gjinore në nivelin vendor gjatë periudhës **01 Maj– 30 Korrik 2025**.



2.3.1. Kostot e Planeve për Bashkitë e Vogla (me më pak se 50,000 banorë)

Aktiviteti	Produkti	Vlera (ALL)	Realizuesi i Aktivitetit
Ofrim i Asistencës për Hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar			
1. Mbledhja e të dhënave	1.1 Përgatitja e instrumentave për mbledhjen e të dhënave (pyetësorëve)	50,000.00	SHKBSH
	1.2 Regjistri i shërbimit	40,000.00	SHKBSH
2. Analiza e të dhënave	2.1 Përpunimi i të dhënave	50,000.00	SHKBSH
	2.2 Validimi i të dhënave	40,000.00	SHKBSH
3. Interpretimi i të dhënave	3.1 Hartimi i Raportit të Diagnozës	40,000.00	SHKBSH
	3.2 Validimi i Raportit të Diagnozës me grupin e punës në bashki	30,000.00	SHKBSH
4. Skenarët e Përmirësimit	4.1 Hartimi i Skenarëve të Përmirësimit të Shërbimit	40,000.00	SHKBSH
	4.2 Përzgjedhja e skenarëve me grupin e punës në bashki	30,000.00	SHKBSH
5. Plani i Arsimit Parauniversitar	5.1 Draftimi i Planit të Arsimit Parauniversitar	58,000.00	SHKBSH
	5.2 Konsultimi i Planit me grupin e punës në bashki	20,000.00	SHKBSH
	5.3 Plani final pas rishikimeve të mundshme	10,000.00	SHKBSH
Lehtësimi dhe Koordinimi	Lehtësim, harmonizim metodologjik dhe mbështetje në interpretimin e kuadrit ligjor	12,000.00	Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
TOTAL		420,000.00	
Kontributi i Shoqatës Kombëtare të Bashkive		70%	
Kontributi i Bashkisë		30%	



2.3.1. Kostot e Projektit për Bashkitë e Vogla (me më pak se 50,000 banorë)

Aktiviteti	Produkti	Vlera (ALL)	Realizuesi i Projektit
Ofrim i Asistencës për Hartimin e Planit të Barazisë Gjinore			
1. Mbledhja e të dhënave	1.1 Përgatitja e instrumentave për mbledhjen e të dhënave (pyetësorëve)	50,000.00	SHKBSH
	1.2 Regjistri i shërbimit	40,000.00	SHKBSH
2. Analiza e të dhënave	2.1 Përpunimi i të dhënave	50,000.00	SHKBSH
	2.2 Validimi i të dhënave	40,000.00	SHKBSH
3. Interpretimi i të dhënave	3.1 Hartimi i Raportit të Diagnozës	40,000.00	SHKBSH
	3.2 Validimi i Raportit të Diagnozës me grupin e punës në bashki	30,000.00	SHKBSH
4. Skenarët e Përmirësimit	4.1 Hartimi i Skenarëve të Përmirësimit të Shërbimit	40,000.00	SHKBSH
	4.2 Përzgjedhja e skenarëve me grupin e punës në bashki	30,000.00	SHKBSH
5. Plani Barazisë Gjinore	5.1 Draftimi i Planit të Barazisë Gjinore	58,000.00	SHKBSH
	5.2 Konsultimi i Planit me grupin e punës në bashki	20,000.00	SHKBSH
	5.3 Plani final pas rishikimeve të mundshme	10,000.00	SHKBSH
Lehtësimi dhe Koordinimi	Lehtësim, harmonizim metodologjik dhe mbështetje në interpretimin e kuadrit ligjor	12,000.00	Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
TOTAL		420,000.00	
Kontributi i Shoqatës Kombëtare të Bashkive		70%	
Kontributi i Bashkisë		30%	



SHOQATA
KOMBETARE
E BASHKIVE
TE SHQIPERISE

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale,

Nënshkruar më ____/____/2025.

Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë

Bashkia Patos

Drejtore Ekzekutive

Kryetari

Adelina FARRICI

Fation DURO

